

PROGETTO CO-FINANZIATO DALL'UNIONE EUROPEA



REGIONE DEL VENETO



MINISTERO del LAVORO
e delle POLITICHE SOCIALI



MINISTERO
DELL'INTERNO

FONDO ASILO, MIGRAZIONE E INTEGRAZIONE (FAMI) 2014-2020

ASIS – Accompagnamento scolastico all'integrazione sociale
PROG. 1278 – FAMI 2014-2020 – OS 2 – ON 2 – lett. c)

SI FUNKSIONON SISTEMI I ARSIMIT DHE FORMIMIT NE RAJONIN E VENETOS



VENETO LAVORO


SI FUNKSIONON SISTEMI I ARSIMIT DHE FORMIMIT NE RAJONIN E VENETOS

■ STRUKTURA E SISTEMIT ARSIMOR

Sistemi i arsimit italian perbehet nga keto cikle studimi: cikli parashkollor per femijet e grupmoshes 3 deri 5; cikli i pare shkollor qe perbehet nga shkolla fillore, e cila zgjat 5 vjet, dhe ndiqet nga cikli i dyte shkollor i nivelit te pare, i cili quhet shkolla e mesme inferiore e zgjat 3 vjet. Me perfundimin e ketij cikli nxenesit mund te rregjistrohen ne ciklin e larte shkollor te nivelit te dyte (e ashtuquajtura shkolla e mesme superiore), e cila zgjat 5 vjet dhe perbehet nga disa lloje shkollash te mesme ose institute trajnimi e formimi teknik e profesional.

Si alternative te shkolles se mesme te pergjithshme nxenesi mund te zgjedhe te rregjistorhet ne kurse 3-4 vjeçare te formimit profesional ose te trajnimit, ku permbushet e drejta dhe detyrimi per arsimim e formim profesional. Ata nxenes qe perfundojne ciklin shkollen e mesme superiore, duke kaluar provimin e shtetit (maturen shtetore), mund te regjistrohen ne ciklin e trete shkollor, te ashtuquajturat kurset e studimit te larte (Universiteti; AFAM – Formimi i larte muzikor dhe artistik; ITS – Instituti i larte teknik).

STRUKTURA E SISTEMIT ARSIMOR



I DETYRIMI PER ARSIMIM DHE STRUKTURA E SITEMIT SHKOLLOR

Ne Itali **arsimi i detyruar** zgjat **10 vjet**, nga mosha 6 deri ne 16 vjet, dhe perben 8 vjetet e pare te ciklit te pare shkollor (5 vjet te shkolles fillore dhe 3 vjet te shkolles dytesore te grades se pare – shkolla 8 vjeçare) dhe dy vjet te ciklit te dyte (shkolla e mesme)¹. Pas ciklit te pare arsimor, dy vitet e fundit shkollore te detyruara (nga mosha 14 deri ne moshen 16 vjet), mund te ndiqen ne shkollen e larte (si lice-te, institutet teknike dhe institutet profesionale), ose ne shkollat rajonale te formimit profesional. **Ky detyrim aplikohet per te gjithë nxenesit e huaj, te rregullt apo jo te rregullt, me apo pa leje qendrimi.**

Detyrimet per arsim i shtohet e drejta dhe detyrimi per shkollim dhe formim per te pakten 12 vjet, ose deri ne arrijten e nje kualifikimi profesional tre vjeçar, para se te arrije moshen 18 vjet². Te rinjte 15 vjeçare mund te zgjedhin te zevendesojne vitin e fundit te shkolles se detyruar me nje kontrate “formim-pune” (apprendistato – kontrate, me te cilen te rinjte kane mundesi te formohen profesionalisht dhe te punojne ne sektorin ku po formohen), duke plotesuar keshtu formimin profesional ne vendin e punes. Kjo eshte nje alternative e shkolles se mesme apo formimit profesional.

Shkolla e detyruar mund te ndiqet ne shkollat shteterore ose ne shkollat e barabarta (sipas Ligjit nr. 62 te vitit 2000), qe perbejne sistemin publik te shkollimit. Ne alternative mund te kryhet edhe duke ndjekur e duke permbushur disa kushte – edhe ne shkollat jo te barabarta (sipas Ligjit nr. 27 te vitit 2006) ose nepermjet shkollimit ne familje. Ne perfundim te shkollimit te detyruar (ne fund te vitit te dyte te shkolles se mesme), nxenesi qe vendos te mos vazhdoje studimet pertej nivelit te detyruar, i leshohet nje deklarate qe verteton kompetencat e fituara dhe permbushjen e detyrimit per shkollim.

Per te siguruar nje formim te barabarte ne te gjitha shkollat italiane jane percaktuar te gjitha njohurite dhe “kompetencat kryesore te qytetarisë”, qe nxenesit duhet te kene fituar ne fund te ciklit shkollor te detyruar, dhe qe kane te bejne me **4 asetet kulturore**: te gjuhes italiane, matematikes, shkences e teknologjise dhe historise e sociologjise.

Pergjegjese per administrimin e sistemit shkollor eshte **Ministria e Arsimit, Universitetit e Shkencave (MIUR)**, me qender ne Rome, e cila vepron ne nivelin lokal nepermjet **Zyrave arsimore rajonale (USR)**, te cilat kryejne kete detyre edhe ne nivel provincash. Keto zyra duhet te monitorojne respektimin e rregullave arsimore, zbatimin e sistemit shkollor, efikasitetin formues dhe respektimin e standarteve te programuara.

1. Artikulli nr. 34 i Kushtetutes italiane percakton detyren per arsimim per “te pakten 8 vjet”, detyrimi mbaron ne moshen 14 vjet. Ligji nr. 296 i 27 i dhjetorit 2006, i ashtuquajtur “Legge finanziaria 2007”, e zgjati kete detyrim deri ne moshen 16 vjet.

2. Kjo parashikohet nga Ligji nr. 53 i 28 marsit 2003, i ashtuquajtur “Legge Moratti”, i cili trasformoi ne menyre themelore sistemin shkollor italian.

IKLI PARASHKOLLOR

Edukimi per grupmoshen **0-3 vjet** ofrohet neper **çerdhet (asili nido)**, te cilat nuk bejne pjese ne sistemin arsimor nen kompetencen e Ministrise se Arsimit. Ky sherbim menaxhohet nga Bashkite, ne perputhje me udhezimet e pergjithshme te vendosura ne nivel rajonal. Rajoni i Venetos, duke pasur parasysh rendesine sociale te ketij cikli arsimor, i mbeshitet financiarisht keto sherbime arsimore (Ligji rajonal nr. 32 i vitit 1990).

Ne grupmoshen **3-6 vjet**, edukimi ofrohet ne **kopshtet e femijeve (scuole dell'infanzia)**, zgjat 3 vjet dhe jane te parashikuara nga sistemi i arsimimit dhe formimit, por nuk jane te detyruara. Ne Rajonin e Venetos, kopshtet e femijeve jo shteterore jane te financuara sipas Ligjit rajonal nr. 23 i vitit 1980.

Orari i ciklit parashkollor eshte **40 ore** ne jave per 35 jave ne vit, dhe mund te **zgjatet ne 50 ore** ne jave. Familjet kane mundesine te kerkojne nje **orar te reduktuar** te frekuentimit, te limituar gjate paradites per **25 ore ne jave**.

IKLI I PARE I SHKOLLIMIT

Cikli i pare i shkollimit zgjat **8 vjet**, frekuentimi eshte i detyruar dhe organizohet ne dy segmente:

- Shkolla fillore (nga mosha 6 deri ne 11 vjet), zgjat 5 vjet;
- Shkolla 8 vjeçare (nga mosha 11 deri ne 14 vjet), zgjat 3 vjet.

ESCUELA PRIMARIA

Shkolla fillore eshte e detyruar, zgjat 5 vjet (nga mosha 6 deri ne 11 vjet) dhe zhvillohet ne shkollat shteterore ose ne ato private te njohura nga Ministria e arsimit. Mund te regjistrohen ne shkollen fillore te gjithë femijet qe mbushin 6 vjet deri ne daten 31 dhjetor te vitit shkollor perkates (mund te regjistrohen parakohe edhe ata femije qe mbushin 6 vjet para dates 30 prill te vitit ne vazhdim). Regjistrimi mund te behet tek shkolla e njesise territoriale perkatese te vendbanimit te femijes ose ne nje tjetër institucion shkollor. Orari mesimor javor parashikon keto opsione:

- **24 ore** ne jave,
- **27 ore** ne jave;
- **deri ne 30 ore** ne jave, brenda te cilave perfshihen edhe aktivitet shtese mbi ato te parashikuara ne 27 oret javore (deri ne 3 ore plus ne jave);
- **40 ore** ne jave, perfshire ne to dhe orari i mences. Ky orar njihet si "modelli" me kohe te plote.

Leksionet jane te shperndara ne 5 dite, nga e hena ne te premte, por mund te perfshihet dhe dita e shtune.

Lendet qe zhvillohen gjate ketyre 5 vjeteve jane: gjuha italiane, gjuha angleze, historia, gjeografia, matematika, shkenca, teknologjia dhe informatika, muzika, arti figurativ,

edukimi fizik, teknologjia. Gjate ketyre viteve studiohet dhe lenda “Qytetaria dhe Kushtetuta” dhe me zgjedhje studenti mund te ndjehet lenden e fese katolike.

Mesuesit e shkolles filllore mund te japin mesim te gjitha lendet, ndersa parashikohet nje mesues tjetër për mesimin e gjuhes angleze dhe fese katolike. Ne klasat me orar 24, 27 ose 30 ore parashikohet prezenca e nje mesuesi te vetem; për klasat me orar javor prej 40 oresh parashikohet prezenca e dy mesuesve, qe zevendesojne njeri - tjetrin.

Vleresimi i ecurise se nxenesit ne mesime behet gjate vitit shkollor dhe ne fund te tij, nepermjet vendosjes se nje note qe shkon nga 0 ne 10 ku nota kaluese eshte 6.

SHKOLLA DYTESORE E NIVELIT TE PARE *(ose shkolla 8 vjeçare - 9 Vjeçare ne Shqiperi)*

Shkolla dytesore e nivelit te pare ose sic mund ta quajme ndryshe shkolla 8 vjeçare, ne Itali zgjat 3 vjet (nga mosha 11 deri 14) dhe zhvillohet ne shkollat shteterore ose ne ato private te njohura nga Ministria e Arsimit. Leksionet jane te organizuara ne 5 dite, nga e hena ne te premte, por shpesh here mund te kete leksion dhe ditën e shtune. Parashikohen minimalisht 990 leksione ne vit, qe korrespondojne me 30 ore javore. Orari mesimor javor parashikon keto opsione:

- “orari normal”, qe parashikon **30 ore ne jave** (29 ore plus 1 ore te dedikuar studimit ne thelesi te letersise), qe korrespondojne ne 990 ore ne vit;
- “orari i zgjatur”, qe parashikon **mesatarisht 36 ore ne jave**, ose ne raste te vecanta 40 ore ne jave, qe perfshin dhe orarin e mences.

Lendet e parashikuara jane: gjuha italiane, gjuha angleze dhe nje gjuhe e dyte e bashkimit europian, historia, gjeografia, matematika, shkenca, muzika, art dhe vizatim, teknologji dhe lenda “Qytetaria dhe Kushtetuta”. Mesimi i fese katolike eshte nje lende me zgjedhje për nxenesit.

Gjate shkolles 8 vjeçare nxenesit kalojne klasen nese marin te pakten noten 6 ne te gjitha lendet dhe ne sjellje.

Ne fund te vitit te fundit te 8 - vjeçares, nxenesit duhet te kalojne nje Provim Shteti me noten minimale kaluese 6/10 për te mare diplomën e shkolles 8 – vjeçare, e cila jep dhe te drejten e regjistrimit ne shkollen e mesme.

Nxenesit e huaj qe kane mbushur 16 vjet dhe:

- kane diplomën e shkolles 8 - vjeçare (9 - vjeçare ne Shqiperi) ose nje titull shkollor ekuivalent, mund te regjistrohen ne shkollen e mesme italiane;
- nuk kane diplomën, por kane frekuentuar shkollen për te pakten 8 vjet ne vendin e tyre te origjines ose ne nje shtet tjetër, mund te regjistrohen ne shkollë me dokumentat e tyre shkollore te perkthyer ne gjuhen italiane;
- nuk kane diplomën e shkolles 8 - vjeçare dhe nuk e kane frekuentuar shkollen për te pakten 8 vjet ne vendin e tyre te origjines ose ne nje shtet tjetër, munden te regjistrohen ne Qendrat Provinciale te Arsimit për te rriturit (CPIA - shiko ne vijim) dhe pas diplomës mund te regjistrohen ne shkollen e mesme.

SHKOLLA DYTESORE E NIVELIT TE DYTE *(shkolla e mesme)*

Pasi kane frekuentuar shkollen 8 - vjeçare dhe kane ndjekur Provimin e Shtetit, nxenesit duhet te regjistrohen ne ciklin tjetër te shkolles, qe eshte shkolla dytesore e nivelit te dyte ose sic mund ta quajme ndryshe shkolla e mesme. Shkolla e detyruar zgjat deri ne moshen 16 vjet dhe perfshin dhe dy vitet e para te shkolles se mesme, e cila perbehet nga.

- shkolla e mesme, ku hyjne:
 - Lice-te,
 - Institutet teknike,
 - Institutet profesionale.
- **arsimimi dhe formimi profesional (lePF)**, ku hyjne:
 - Formimet profesionale, qe zgjasin 3-4 vjet te autorizuar nga rajoni perkates,
 - Trajnimet, qe permbushin te drejten dhe detyrimin per arsimim.

SHKOLLA E MESME

Shkolla dytesore e nivelit te dyte, si ne rastin e **liceve, te instituteve teknike** dhe **instituteve profesionale**, zgjat ne **terresi 5 vjet**, nga moshja **14 deri ne 19 vjet**.

Ekzistojne **6 lloje licesh**: *artistik, klasik, i gjuheve te huaja, muzikal e koral, shkencor dhe liceu i shkencave humane*. Pas dy viteve te para, liceu artistik ofron 6 drejtime: *artet figurative, arkitektura e mjedisit, audioviziv dhe multimedial, vizatim, grafia, skenografia*.

Liceu shkencor, pervec orientimit kryesor, ofron dhe nje orientim ne shkencat e aplikuar, ndersa liceu i shkencave humane ofron dhe drejtimin ekonomik – shoqeror.

Institutet teknike, pas dy vjeçarit te perbashket, ofrojne drejtime te ndryshme studimi ne sektorin ekonomik e teknologjik, te cilet nen ndahen ne 2 dhe 9 drejtime:

INSTITUTET TEKNIKE		
EKONOMIK		
Administrim, Finance dhe Marketing	Turizem	
TEKNOLOGJIK		
Mekanika, Mekatronika dhe Energjia	Transporti dhe Logjistika	Elektronika dhe Elektroteknika
Informatika dhe Telekomunikacioni	Grafika dhe Komunikacioni	Kimia, Materialet dhe Bioteknologjia
Sistemi i modes	Agronomia, Agroushqimore dhe Agroindustria	Ndertimi, Mjedisi dhe Territori

Institutet profesionale ofrojnë drejtime në sektorin e shërbimeve dhe në ato të industrisë dhe artizanatit, të organizuara në 4 e 2 ndarje:

INSTITUTET PROFESSIONALE	
SHERBIMET	
Sherbime për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural	Sherbime Shoqërore dhe Shëndetësore
Sherbime për Pijet, Ushqimet dhe mikpritjen në Hotele	Sherbimet tregtare
INDUSTRIA DHE ARTIZANATI	
Prodhime Industriale dhe Artizanale	Mirembajtja dhe Asistenca Teknike

Një nxënës, që të pranohet në vitin vijues të shkollës së mesme, duhet të ketë të paktën notën 6/10 në të gjitha lëndet e në sjellje. Nëse në një apo disa nga lëndet, nota është më e ulët se 6/10, studenti duhet të mbushë mungesat në njohuri brenda fillimit të vitit shkollor vijues. Nëse vlerësimi që bëhet mbi njohuritë para fillimit të vitit të ri shkollor është pozitiv, nxënësi pranohet në vitin shkollor vijues, nëse vlerësimi është negativ nxënësi duhet të përsërisë vitin shkollor.

Ne perfundim te shkolles se mesme ne lice, ne institutet teknike dhe ato profesionale nxenesi i nenshtrohet Provimit te Shtetit, qe perbehet nga nje provim me shkrim dhe nga nje provim gojor. Nota perfundimtare percaktohet nga notat e te dyja provimeve dhe shprehet ne 100 pike. Nota kaluese eshte nga 60 deri 100 pike. Nxenesve, qe kalojne provimin final, iu leshohet nje diplome pjekurie, e cila u jep mundesine te regjistrohen ne shkollen e larte (Universitet, AFAM – Formimi i larte muzikor dhe artistik; ITS – Istitute teknike te larta).

SHKOLLIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL RAJONAL (IEFP)

Nese nxenesi do te frekuentoje nje shkolle te mesme me te shkurter, qe ofron mundesine e mesimit te nje zanati ne menyre te shpejte, mund te zgjedhe nje nga kurset e formimit profesional te autorizuar nga Rajoni i Venetos³. Kurset rajonale te formimit profesional jane kurse 3, 4 ose 5 vjeçare te realizuar nga **agjensi** te formimit profesional te akredituar nga Rajoni i Venetos, ose nga **institute shtetore te arsimimit te nivelit te dyte**. Per t'u pranuar ne keto kurse nxenesi duhet te kete plotesuar ciklin e pare te shkolles dytesore e te jete **jo me shume se 15 vjet**. Keto kurse, pas kalimit te provimit final, japin **kualifikimin (Operator)** ne rastin e kurseve **tre vjeçare** dhe **diplomen (Teknike)** ne rastin e kurseve **kater vjeçare**. Kurset tre vjeçare te aktivizuara aktualisht ofrojne **22 figura** profesionale kurse ato kater vjeçare **21 figura profesionale**.

Qellimi i kurseve IEPF tre - vjeçare dhe kater - vjeçare eshte t'ju ofroje mundesine te rinjve nga 14-17 vjet te futen menjehere ne boten e punes, duke ndjekur nje kurs shkollor me te shkurter se kursi normal.

Te rinjte, qe ndjekin diplomen Teknike, mund te regjistrohen ne shkollen e larte pas ndjekjes se nje viti akademik specifik. Kualifikimi tre vjeçar dhe diploma kater vjeçare japin gjithashtu mundesine e regjistrimit ne kurset e formimit profesional te ashtuquajturat te "nivelit te dyte" ose post kualifikimi /post diplomimi.

FORMIMI PROFESIONAL NEPERMJET TRAJNIMIT, QE PERMBUSH TE DREJTEN DHE DETYREN PER ARSIMIM

Nepermjet formes se kontrates "**trajnim qe permbush te drejten dhe detyren per arsimim**", nxenesi ka mundesine te ndjekoje nje kualifikim profesional tre - vjeçar ose te mbroje diplomen profesionale. Kjo do te thote qe nxenesi ka mundesine te permbush te drejten dhe detyren per shkollim ne vendin e punes, si alternative te frekuentimit te shkolles se mesme te pergjithshme apo asaj profesionale.

Trajnimi qe permbush te drejten dhe detyren per shkollim eshte nje alternative per nxenesit qe kane mbushur moshen 15 vjet dhe lejohet te frekuentohet nga moshja **15 deri ne 18 vjet**. Ne vitin 2012 Rajoni I Venetos ka nenshkruar nje marrveshje me

3. Formimi profesional rajonal ka qene nje nga pikat kryesore te reformes se sitemit arsimor te Rajonit te Venetos, Ligji rajonal nr. 8 i vitit 2017.

partneret sociale, ku jane percaktuar profilet e trajnimit dhe numuri i oreve (440 ore ne vit) per trajnimin qe duhet te kryhet brenda apo jashte ndermarjes. Sipas marrveshjes rajonale, mund te marin pjese ne kete lloj trajnimi te gjithë te rinjte e moshes nga **15 deri ne 25 vjet**; kontrata e trajnimit zgjat **3 vjet** (plus nje vit ne rastin kur nxenesi deshiron te ndjeke vitin e diplomes) dhe mbulon gjithë sektoret private.

I SHKOLLA E LARTE

Sistemi i arsimit te larte (niveli i trete i shkollimit) ne Itali perbehet nga:

- arsimi i ofruar nga **Universitetet**,
- arsimi i ofruar nga **AFAM – Formimi i larte muzikor dhe artistik**,
- arsimi dhe formimi teknik i ofruar nga **ITS – Istitutet teknike te larta**.

ARSIMI UNIVERSITAR

Sistemi universitar italian perbehet nga **97 institute universitare**, prej te cilave:

- **67 Universitete Shteterore**,
- **19 Universitete Private** te njohua nga Ministria e Arsimit,
- **11 Universitete Private telematike** te njohura nga Ministria e Arsimit.

Ekzistojne edhe dy lloje te tjera institutesh, qe leshojne tituj te barabarte me ato universitare: **Shkollat e larta per ndermjetesuesit gjuhesore (Ssml)**, te cilat ofrojne kurse tre - vjecare dhe leshojne tituj te barabarte me diplomën universitare per shkenca dhe ndermjetesim gjuhesor (diploma e universitetit 3 - vjeçar) dhe **Istitutet e specilaizimit ne psikoterapi**, te cilat leshojne diploma specializimi ne psikoterapi, te barabarta me diplomat e specializimit ne psikologji dhe ne disiplinat e peraferta.

Kurset organizohen ne keto fusha te studimit: shëndetësore, shkencore, sociale dhe humaniste. Sipas *Kornizes kombetare te titujve per arsimin e larte*, programet universitare mund te jene:

- **cikli i pare**, qe zgjat **3 vjet**, i cili çon ne mbrojtjen e **diplomes trevjeçare (L)**;
- **cikli i dyte**, qe mund te jete **dy vjeçar** ose nje **cikel i plote**, qe çon ne mbrojtjen e **diplomes maxhistrale (LM)**.

Studimet ne mjekesi e kirurgji, farmaci, veterinari, stomatologji, juridik, shkencat e arsimit fillor dhe - vetem ne disa raste – inxhinieri ndertimi e arkitektura, nuk jane te artikuluar ne formen 3+2, por ofrohen si **cikle te plota studimi (5 ose 6 vjeçar)** dhe çojne ne mbrojtjen e diplomes se ciklit te dyte (**diplome maxhistrale e ciklit te plote**), pa mbrojtur diplomën e ciklit te pare.

FORMIMI I LARTE MUZIKOR DHE ARTISTIK (AFAM)

Institutet qe bejne pjese ne **Formimin e larte muzikur dhe artistik (Afam)**, jane:

- **Akademite e arteve te bukura**, qe pergatisin ne ushtrimin e artit dhe zhvillojne kurse pikturë, skulpturë, dekorimi dhe skenografie.
- **Institutet e larta per industrite artistike (Isia)**, te cilat ofrojne nje formim specifik ne fushen e dizenjës (vizatim dhe projektim grafik).
- **Akademia kombetare e artit dramatik Silvio d'Amico**, me qender ne Rome, e cila ofron kurse formimi per aktore e regjizore te teatrit dramaturgjik ku pranohen studente te moshes 18 deri 25 vjet.
- **Konservatori i muzikes**, te cilat kane per qellim edukimin muzikor.
- **Akademia kombetare e baletit**, me qender ne Rome, e cila ka si qellim formimin e valltareve, solistëve dhe koreografeve te baletit.

Sipas Kornizes kombetare te titujve, programet e studimit ne sektorin e Afam mund te jene:

- **Tre vjeçare te ciklit te pare**, te cilat cojne ne mbrojtjen e **diplomes akademike te nivelit te pare**;
- **Dy vjeçare te ciklit te dyte**, te cilat cojne ne mbrojtjen e **diplomes akademike te nivelit te dyte**.

Si per universitetin ashtu dhe per sektorin Afam, vleresimi i ecurise ne studime shprehet me noten maksimale **30 per cdo lende** (nje shkalle notash qe shkon nga 0 ne 30) ku nota kaluese eshte 18. Ndersa nota **perfundimtare maksimale eshte 110** (nje shkalle notash qe shkon nga 0 ne 110, ku nota minimale kaluese eshte 66). Per te mbrojtur diplomen ne nje universitet apo ne nje institut Afam, ne perfundim te ciklit te pare dhe ciklit te dyte, studenti duhet te paraqise **nje teze** ose te mbaje nje **provim final individual**. Vleresimi behet nga nje komision i perbere nga disa profesore.

INSTITUTET E LARTA TEKNIKE (ITS)

Institutet e larta teknike (ITS) ofrojne nje formim ne keto gjashte fusha teknologjike: ne efikasitetin e energjise, ne mobilitetin e qendrueshem, ne teknologjite e reja te jetes, ne teknologjite e reja e Made in Italy, ne teknologjite inovative per pasurite dhe aktivite kulturore e turizem dhe ne teknologjite e informacionit e komunikimit.

Kurset e ofruar nga ITS zgjasin mesatarisht **4 semestra** (per nje totale prej 1800-2000 oresh); parashikojne leksione teorie, aktivitet laboratorike e trajnime ne ndermarrje (edhe jashte shtetit italian). Trajnimi ne ndermarrje duhet te perbeje te pakten 30% te totalit te programit. Kurset perundojne me kryerjen e disa provimeve mbi aftesite e fituara. Neper provime komisioni vleresues eshte i perbere nga perfaqesues te shkolles, univeristetit, te formimit profesional dhe eksperte te botes se pune.

Kurset ITS kane si objektivi mbrojtjen e **diplomes se teknikut superior**, qe perben titullin kualifikues per te mare pjese ne konkurset publike dhe hyrjen ne universitet. Ato gjithashtu jepin mundesine e hyrjes ne menyre te menjehershme ne boten e punes.

INTERVENIMET E RAJONIT TE VENETOS NE MBESHETJE TE FAMILJEVE

Rajoni i Venetos parashikon nje sere masash per te mbeshtetur familjet ne keto shpenzime arsimore⁴:

- **“Mbeshtetje financiare per Transport”**, qe mbulon pjeserisht shpenzimet e transportit per te shkuar ne institutet shkollore dhe te formimit profesional,
- **“Mbeshtetje financiare per Shkolle”**, kontribut per te mbuluar pjeserisht shpenzimet per regjistrimin dhe frekuentimin e shkolles, gjithashtu dhe per te mbuluar aktivitetet mesimore te parashikuara per nxenesit me aftesi te kufizuara,
- **“Meshtetje financiare per Librat”**, qe mbulon ne menyre totale ose pjeserisht shpenzimet per blerjen e librave shkollore dhe te mjeteve arsimore,
- **“Libra hua”**, kontribute direkte ne Institutet shkollore shtetore, te barabarta dhe jo te barabarta, te nivelit te pare dhe te nivelit te dyte, dhe Institutet e formimit, per te mbuluar pjeserisht shpenzimet per blerjen e librave shkollore dhe strumenteve didaktike qe iu jepen borxh studenteve me te ardhura te ulta ekonomike;
- **“Bursa studimi”**, te shumes nga 200,00 ne 500,00 euro, qe ofrohen per te perballuar shpenzimet e blerjes se teksteve shkollore dhe te transportit, si dhe per te mare pjese ne aktivite kulturore.

PER ME SHUME INFORMACIONE MUND TI DREJTOHENI NJESISE ORGANIZUESE PER ARSIMIN DHE UNIVERSITETIN TE RAJONIT VENETO - UNITÀ ORGANIZZATIVA ISTRUZIONE E UNIVERSITÀ DELLA REGIONE DEL VENETO.

4. Per kete te shikohet faqja “Scuola - aiuti agli studenti”, ne Portalin e internetit te Rajonit Veneto, <http://www.regione.veneto.it/web/rete-degli-urp-del-veneto/scuola-aiuti-agli-studenti> .

ARSIMIMI I TE RRRITURVE

Mundesite per arsimimin dhe trajnimin e te rriturve kane si qellim, nga njera ane t'u ofrojne nje titull studimi atyre te rriturve qe nuk kane nje titull te tille, dhe nga ana tjeter t'u ofrojne nje titull me te larte atyre te rinjve qe e kane nje titull shkollor por synojne per nje titull me te fuqishem, qe t'i ndihmoje te hyjne me lehte ne boten e punes. Kurset e arsimimit per te rriturit zhvillohen ne **Qendrat provinciale te arsimimit per te rriturit (CPIA)**, te cilat gjate viteve te fundit kane perfshire dhe zevendesuar Qendrat territoriale permanente dhe Shkollat e nates. Ne Rajonin e Venetos, CPIA – te jane te aktivizuara ne secilen Province dhe perbejne nje tipologji te institucionit shkollor me te njeten autonomi te shkollave autonome territoriale.

Kurset e arsimimit per te rriturit ne CPIA perbehen nga:

- **kurse te nivelit I**, per te mare kualifikimin arsimor te ciklit te pare te arsimimit dhe certifikaten, qe verteton pervesimin e aftesive themelore te arsimimit te detyrueshem,
- **kurse te nivelit II**, per te mare nje diplome ne arsimin teknik, profesional ose artistik,
- **kurse te alfabetizimit** dhe te **mesimit te gjuhes italiane**, te mbajtura per studente te huaj me qellimin e mbrojtjes se titullit te njohjes se gjuhes italiane me nje note minimale A2 sipas Kornizes se Perbashket Evropiane te References per Gjuhete (QCER), e aprovuar nga Keshilli Evropian.

Mund te regjistrohen ne kurset e ofruara nga CPIA kushdo qe ka mbushur moshen 16 vjet (ne raste te rralla pranohen dhe studente qe jane vetem 15 vjet).

Pervec kesaj, ne Veneto, per personat ne moshe mbi 18 vjet, qe nuk kane ndjekur nje shkollen per te pakten 12 vjet duke shlyer te drejten dhe detyren per arsimim dhe formim mund te ndjekin kurset formuese qe zgjatin 1 vit, 800 ore totale, gjate te cilit parashikohet nje periudhe trajnimi prej 120 oresh. Keto kurse promovohen dhe financohen nga Rajoni i Venetos dhe mundesojne arrijten e nje kualifikimi profesional.

SI TE RREGJISTROHESH

Per t'u rregjistruar ne shkollat duhet te plotesoni nje formular dhe te dorezoni dokumentat e kerkuara ne shkollat.

Ne rastin e femijeve dhe te rinjve qe kane arritur prej pak kohesh ne Itali, mund te rregjistrohen ne shkollat edhe nese viti shkollor ka filluar. Nese studenti eshte me i vogel se 18 vjet mund te regjistrohet ne shkollat edhe nese nuk ka ende nje leje qendrimi.



REGIONE DEL VENETO